

VENDIM
Nr. 935, datë 25.11.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT) DHE BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË DURRËS DHE LEZHË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 837 115 264 (tetëqind e tridhjetë e shtatë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, për riforcimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, nga bashkitë Durrës dhe Lezhë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’u kalojë bashkive Durrës dhe Lezhë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës, në masën 326 726 371 (treqind e njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e njëzet e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekë, për riforcimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

b) Bashkisë Lezhë, në masën 510 388 893 (pesëqind e dhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë, për riforcimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para do të jetë në masën 167 423 052 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e pesëdhjetë e dy) lekë dhe do të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet të fondit të rindërtimit.

4. Fondi i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, t’u kalojë bashkive Durrës dhe Lezhë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 65 345 274 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e treqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi në masën 102 077 778 (njëqind e dy milionë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës dhe Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama